

NEXHAT AGOLLI
RAMAZAN BOGDANI

KËRKIME KOREOGRAFIKE NË ZALL-DARDHË

Në gjysmën e dytë të muajit korrik të vitit 1964, sektori i koreografisë të Institutit të Folklorit, në bashkëpunim me bashkëpunëtorë të jashtëm, organizoi një ekspeditë kërkimore për vallet në lokalitetin e Zall-Dardhës të rrethit të Dibrës (Peshkopi).

Kërkimet u bënë në këto pika: Zall-Dardhë (qendër lokaliteti), Lashkizë, Stanet e Lashkizës, Kraj-Reç, Bardh-Reç, Zall-Reç si dhe me informatorë nga fshatra të tjerë si Draj-Reç, Gur-Reç¹, etj. Përveç tetë valleve të transkriptuara (përshkruara) u morën të dhëna lidhur me vallet, rastet kur luhen, shtrukturën si dhe shenime të tjera me karakter historik e etnografik. Këtij materiali do t'i shtojmë edhe dy valle të filmuara prej grupit të valleve të të rinjve po të këtij lokaliteti, me rastin e festivalit të klasës punëtore që u zhvillua në Tiranë në vitin 1961.

* * *

Lokaliteti i Zall-Dardhës është qendër administrative e dy nëndarjeve të vogla krahinore: Reç e Dardhë, të cilat formojnë një unitet ekonomik, historik e etnografik, sepse kanë të njëjtat zakone dhe tradita, të njëjtën mënyrë jetese, si dhe të njëjtat tipare në fushën e krijimtarisë artistike popullore.

Kjo nëndarje krahinore, gjeografikisht, ndodhet në pjesën veriore të rrethit të Dibrës. Nga V.L. kufizohet me Bicajt e Kuksit, nga J. me lokalitetin e Fush-Alisë, nga L. me lokalitetin e Sllovës dhe nga P. me lokalitetin e Lurës. Nga krahu i majtë rrethohet me një varg malesh që zbresin buzë lumit, Drinit të Zi, i cili përbën kufirin natyror nga ana e djathtë. Nga pikëpamja gjeografike ky vend është i mbyllur². Kjo veçori natyrore, influenoi, përveç të tjerave, në kërkimin e valleve pikërisht në këtë krahinë.

Toka, ku shtrihen sot fshatrat e këtij lokaliteti, dikur ka qenë vend i pabanueshëm. Gojëdhëna tregon, se fushat e vogla buzë Drinit dhe kodrat përbri, filluan të banohen afërsisht aty mbas shek. të X-të nga banorë të ardhur nga fshatrat e Mbi Shkodrës. Këta fise, të cilat me kalimin e kohës u shtuan, i ruajtën për një kohë të gjatë zakonet dhe traditat e tyre. Ata ishin të fuqishëm dhe u treguan luftëtarë të pamposhtun si në periudhën e ndritur të Skënderbeut ku mbushën radhët e ushtrisë së tij dhe treguan trimëri kundër turqëve, ashtu edhe në kohë të mëvonëshme dhe gjatë luftës N.çl.

1) Fshati Gur-Reç, që më parë i përkiste lokalitetit të Zall-Dardhës, sot bën pjesë në lokalitetin e Lurës.

2) Me ndërtimin e rrugës së Rinisë Kukës-Peshkopi në vitin 1947, lokaliteti i Zall-Dardhës u lidh me rrugë automobilistike me qendrën e rrethit, Peshkopinë, Bicajt e Kukësit, etj.

Këto ngjarje frymëzuan rapsodët popullorë në krijimin e shumë këngëve të bukura të përcjellura me çifteli e që sot shpesh na bie rasti t'i dëgjojmë si një evokim i së kaluarës.

Baza ekonomike e çdo familje është prona private mbi mjetet e prodhimit.³ Fshatrat dikur, bile dhe lagjet, bënë një jetë sedantere (të mbyllur). Vendasit merren me bujqësi e blegtori; toka përgjithësisht është e varfër. Mënyra e jetesës në të kaluarën ishte e ulët. Rregjimet anti-popullore të së kaluarës, në këtë drejtim, s'kujdeseshin fare. Në gjendje të vajtueshme ishte edhe arësimi. Gjendja e vështirë ekonomike, veçanërisht gjatë dimrit, kur krahët e punës ishin të tepërta, i detyronte zall-dardhasit të shkonin për punë në qytete të ndryshme si në Pogradec, Elbasan, Kukës, Rrëshen, Bulqizë, Tiranë, etj. Këtu ata punonin si punëtorë krahu, minatorë, karpentierë, etj.

Mbas çlirimit të Atdheut, me vendosjen e pushtetit popullor, në jetën ekonomike, sociale e kulturele, u bënë ndryshime të mëdha. Në krahësim me të kaluarën edhe në jetën familjare u bënë ndryshime të dukshme⁴. Nga një shkollë fillore që ekzistonte më parë, me 14 nxënës e një mësues, sot ka gjashtë të tilla dhe dy 8-vjeçare me më shumë se 800 nxënës e 18 arësimtarë, shumica e të cilëve janë vendës. Në qendër të lokalitetit, në Zall-Dardhë, funksionin prej vitit 1957, shtëpia e kulturës, e cila bën një punë të mirë edukative e politike në masat, organizon foto-ekspozita, leksione për një jetë më të kulturuar, për sportin, higjenën, veshjen, për përhapjen e librit, për përdorimin në bujqësi t'agroteknikës, zhdukjen e mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve.⁵

Në bibliotekën e shtëpisë së kulturës ka një fond prej 500 librash. Ekzistojnë këta grupe: i theatrit, korit, i këngës popullore, etj. Këta grupe, veçanërisht ato të valleve, kanë marrë pjesë në të gjitha festivalet folkloristike të rrethit të Dibrës, dhe në ato të zhvilluara në shkallë kombëtare: në vitin 1952 grupi i të rinjve u nderua me çmimin e parë. Po ky grup, bashkë me grupet e tjera folkloristike të vendit tonë, mori pjesë në festivalin e VII Ndërkombëtar të Rinisë dhe Studentëve në Moskë, ku u nderua me çmimin e tretë. Në qendër të lokalitetit jepen herë mbas here cfaqje nga grupet vendase ashtu dhe nga estrada profesioniste e qytetit të Peshkopisë.

Megjithë emancipimin dhe ndryshimet që kanë nisë të duken në jetën e këtyre malësorëve, ende ruhen të gjalla disa zakone dhe rregulla (në kuptimin e mirë të fjalës) të familjes patriarkale. Familja më e vogël përbëhet prej katër-pesë pjesëtarësh, ndërsa ma e madhja — deri në njëzet. Të gjithë pjesëtarët janë të barabartë. Nana dhe babaj gëzojnë autoritet; ky i fundit konsiderohet si i pari i shtëpisë. Lindja e djalit është një gëzim i madh për shtëpinë: shtohet një krah pune, nuk humb vatani (shtëpia) trashëgohen etj. Fejesat në moshë të vogël kanë nisë të lihen, Martesat zakonisht i kanë bërë me fshatrat e lokaliteteve për rreth, dhe jo brenda për brenda fshatit mbasi i konsideronin vajzat si të fisit.

Ajo që të bie në sy në çdo fshat të Zall-Dardhës, është banesa. Në përgjithësi janë dykatëshe, të ndërtuara me gurë, llaç e lëndë pylli. Nuk ndryshojnë fort njera nga tjetra dhe në tërësi formojnë një unitet arki-

3) Vetëm në fshatin Draj-Beç në vitin 1962 asht formuar kooperativa.

4) Nga statistikat mundëm të mbledhim disa shifra: janë ble nga fshatarët, nëpërmjet organeve të tregëtisë 1795 dysheqe, 471 krevatë, 2964 pjata, 283 dollapë guzhine, etj. Gjithashtu ka nisë prishja e frengjive, janë hapur përmbi 1200 dritare.

5) Një punë e madhe në këtë drejtim bëhet veçanërisht mbas vendimit të plenumit të Partisë të vitit 1963 «Mbi gjendjen ekonomike dhe social-kulturale të fshatit dhe masat për përmirësimin e saj».

tektoral si në formën e planimetrisë së jashtme ashtu dhe në ndarjet e brendëshme. Nga jashtë shtepitë kanë ngjyrën e gurit. Dhomat përbrenda janë të mëdha deri 5x5. Muret janë të trashë 70 cm. të suvatuara dhe të lyer me gëlqere. Dhomat kanë tavan dhe dysheme prej dërrase; këto të fundit janë edhe prej çimentoje. Gjatë dimrit përdorin për zjarr oxhakët ose soba prej llamarine. Në dysheme shtrojnë: hasra, qylyma e sexhade të cilat i punojnë vetë.

* * *

Folklori i krahinës së Zall-Dardhës është i pasur në të gjitha gjinitë. Në këtë krijimtari, të trashëguar brez pas brezi, një vend me rëndësi zenë kërcimet popullore. Ato përbëjnë një nga gjinitë më të pasura, më të bukura, e më të larmishme të krijimtarisë folkloristike të kësaj krahine. Këto kërcime janë manifestime të vërteta, nëpërmjet të cilave shprehen vetitë dhe cilësitë më të mira të karakterit, forcës, shkathtësisë, temperamentit dhe në të njëjtën kohë, tregojnë nga bukuria e paraqitjes, ndërtimit dhe ekzekutimit të tyre edhe forcën e madhe krijuese, talentin si valltarë të Zall-Dardhës.

Rastet kur luhen vallet — Në krahinën e Zall-Dardhës vallet luhen në raste të ndryshme:

DASMA — Një nga momentet më të gëzuara të jetës familjare është dasma. Prandaj për të janë krijuar doke e zakone nga më të ndryshmet e të pasurat. Dasmat zakonisht bëhen kur mbarojnë punët bujqësore, nga fundi i gushtit deri në mes të vjeshtës, se edhe mishi në këtë kohë është më i trashë. Festa më e madhe në këtë rast bëhet te djali, për vetë faktin se ardhja e nuses konsiderohet si shtim i një krah pune në familje. Dasmat, sidomos në të kaluarën, fillonin disa ditë përpara; zakonisht mbli-dheshin mbas darke të shtëpisë dhe dhandrit ku e kalonin kohën me valle, këngë e lojra, tregonin ngjarje historike, i binin çiftelisë e tjera.

DITA E VERËS — Festohet më 12 mars veçanërisht nga fëmijët. Kjo ditë simbolizon ardhjen e pranverës. Herët në mëngjez fëmijët mbli-dheshin në sheshin e Manros (një vend sipër fshatit Zall-Dardhë) ku marrin me vehte ushqime: vezë, gështenja, ëmbëlsira, etj. Aty kalojnë disa orë me këngë e valle. Fëmijët ndahen sipas lagjeve të prirë nga një dru i gjatë, në majën e të cilit lidhin dy shami: një të kuqe e një të bardhë. Kur arrijnë në shesh bajrakët (drujt), i ngulin në rrjesht.

Kur kthehen për në shtëpi secili grup bajrakun e ngul përpara shtëpisë. Fëmijët në këto lodra shoqërohen edhe nga të rriturit.

DITA E SHËNGJERGJIT — Festohet më 6 maj. Me këtë rast bëhen dreka e darka. Fëmijët, gjatë ditës, marrin bagëtinë e dalin nëpër kullota; atje gatujnë ushqime dhe hajnë drekën e Shëngjergjit. Zhvillojnë lodra të ndryshme si: kala dibrance, rrasash, ki-ki-ki, shkopa xinglash, hedhin valle, kurse sot luajnë edhe me top. Në mbrëmje ndezin zjarret, e vonë kthehen nëpër shtepitë e tyre.

SHMRAJA — Festohet nga fundi i gushtit me rastin e kthimit të bagëtive nga stanet. Me këtë rast bëjnë darka. Kjo ditë konsiderohet si shtimi i prodhimit të bylmetit, si një gëzim i bashkimit të pjestarëve të familjes dhe i kthimit shëndoshë e mirë të bagëtisë. Mbas darke shkojnë te njeri tjetri për të uruar që kaluan mirë ndër stane, aty këndojnë e kërcëjnë. Në këso rastesh mbli-dheshin burra dhe gra, far'e fis, ose komshij.

Rast tjetër kur luhen vallet janë *STANET* — Gjatë stinës së verës fshatarët i çojnë bagëtitë nëpër bjeshkë si në Fushën e madhe, Maja e Gjagjishtit, stani i Lashkizës, etj. Atje qëndrojnë nga 10 qershori gjer më

31 gusht. Zakonisht në stane bashkohen dy-tri ekonomi së bashku për lehtësi pune. Kjo u jep rast atyre që të jenë afër njeri tjetrit dhe shpesh herë t'i kalojnë netët me kangë e valle.

Vallet luhen edhe në raste festash kombëtare dhe lokale si 28 e 29 nëndori, 23 gushti (dita e çlirimit të rrethit të Peshkopisë) etj. Një rast tjetër ku luhen dhe praktikohen vallet (sidomos mbas çlirimit) janë festivalet me karakter kombëtar dhe lokal.

Në të kaluarën vallet janë luajtur edhe për synetlliqe, kurse në festat fetare si bajram, ramazan, etj. ato nuk janë praktikuar. Nga kjo kuptohet se vallet në këtë krahinë kanë karakter afetar.

Kur luhen vallet (veçanërisht ndër dasma), të pranishmit marrin pjesë gjallërisht me reagimet e tyre, gjë që e bën atmosferën më të gëzueshme. Para se të nisë kërcimi, fillojnë të ndëgjohen të thirrura të lehta. Është fjala për të kërcyer! I drejtohen ndonjerit prej valltarëve më të zot: «A po na luen o burrë», «ngreu e merrja një kcimi», etj. Por, valltarët, nga ana e tyre bëjnë sikur nuk kanë qejfë të kërcëjnë, prandaj presin që t'i lusin përsëri. Kur valltari del për të kërcyer, ky ka të drejtë të zgjedhë shokun për ta mbajtur gjatë valles. Në kërcim e sipër, nga njerëzit për rreth, ndëgjohen fjalë: «bukur kcen o i gzoft zemra», «nuk e patëm kot qi e çuem me kcye», «oh, të lumtë», «he ju lumshin kambët», «kçeni o burra sa të shembet podi (dyshemeja)». Valltarët, nga ana e tyre, gjatë kërcimit nxjerrin ofshamje duke marrë kështu forcë e vullë për më tej në valle. Njerëzit për rreth, nga dëshira për të parë valltarin duke kërcyer më gjatë i thonë: «Veç me tri herë vritet nishani» dhe herherë në të kaluarën (siç thonë) qëllonin me armë n'ajër deri tri herë.

Karakteristika të përgjithëshme — Në të gjitha fshatrat e Zall-Dardhës, si burrat ashtu dhe gratë, kanë vallet e tyre të veçanta. Ato formojnë dy tipe diametralisht të kundërt kërcimi, dhe luhen nga të gjithë ata që kanë prirje, pavarësisht nga mosha: vajza, nuse, të rij, burra, pleq.

VALLET E GRAVE — Vallet e «rrafshta» të grave paraqiten të thjeshta, si në strukturë ashtu dhe në ekzekutim. Përgjithësisht karakterizohen nga një natyrë e qetë. Luhen nga dy, katër ose më tepër valltare të shkëputura nga njera tjetra. Lëvizjet i ekzekutojnë në drejtim të vargut të valles, anash nga e djathta, ose kundrejt njera tjetrës në vend, me çvendosjen e trupit djathtas, majtas si dhe duke u kryqzuar me njera tjetrën në vijë horizontale. Vallet e «rrafshta» të grave, me gjithë thjeshtësinë, në një farë mase paraqesin dhe ndryshime ndërmjet tyre. Pra kemi disa variante të këtyre valleve.

Shembëll nga vallja e «rrafshtë» e vajzave të shkollës fillore Zall-Reç.

Masa I

Katërshja e parë — Hap pak i thyer me të djathtën gjysëm majtas përpara (pika 8) ndërsa e majta afrohet pranë sajë e thyer pak përmbi tokë. Valltaret janë të kapura me duar të thyera zinxhir: e para me dorën e djathtë lëviz shaminë lart në ajër, kurse e fundit të majtën e mban në bel.

Katërshja e dytë

Tetshja e tretë — Hap i vogël mbrapa me të majtën, duart qëndrojnë në atë pozicion.

Tetshja e katërt — Hap afrues me të djathtën në vend.

Masa II

Katërshja e parë — Këmba e djathtë çvendoset pak anash në majë të gishtve. Trupi mbështetet mbi këmbën e majtë

Katërshja e dytë — Hap afrues me të djathtën në vend.

Masa III

Katërshja e parë — Hap me të djathtën anash nga e djathta me rrotullimin e trupit 120° . Valltaret shkeputen nga njera tjetra.


Katërshja e dytë — I njëjti hap me të majtën me rrotullimin e trupit nga e djathta 120° .

Masa IV

Katërshja e parë — I njëjti hap me të djathtën me rrotullimin e trupit nga e djathta 120° . Valltaret kapen me duart e thyera anash, zinxhir.

Katërshja e dytë — Hap kryq i thyer me të majtën mbrapa. Trupi mbështetet lehtas mbi këmbën e majtë. Duart qëndrojnë në atë pozicion.

Shenim — Kjo lëvizje përsëritet disa herë

Valle grash

Valle grash

VALLET E BURRAVE — Repertori i valleve të burrave është më i madh e më i larmishëm. Ato, përkundrazi, në krahasim me kërcimet e grave, dallohen për një pasuri të madhe motivesh, si dhe për një kombinim të bukur figurash. Ndërmjet tyre shquhen: vallet e «randa» dhe vallet e «lehta» vendase. Përveç këtyre dy tipave luhen edhe valle të tjera, të cilat, përveç mënyrës së ndërtimit, dallohen nga të parat dhe si emërtim si p.sh. «Vallja e shpejtë e Zall-Dardhës», «Vallja e Haxhi Kacës», «Xhaferr Kabës», «Vallja Çapkonit», «Vallja e Radomirës», e tjera. Disa syresh shquhen për karakterin e rëndë e burrëror, disa për suplesën e lëvizjeve, kurse disa të tjera për ritmin e gjallë dhe lëvizjet tepër kërcyese, plastike e të zhdërvjellta. Karakteristikë dalluese e këtyre valleve (shumica e të cilëve janë dyshe) asht se, gjithmonë i pari kërcen, ndërsa i dyti vetëm e mban, dhe anasjelltas. Lëvizjet në disa nga vallet e sipërpërmendura ekzekutohen me një ritëm, qoftë të shtruar, qoftë më të shpejtë prej fillimit gjer në fund, kurse në disa të tjera ritmika e lëvizjeve nis ngadalë dhe përnjëherë rritet në crescendo. Por, asht për t'u theksuar se, rritja e lëvizjes nga pikëpamja dinamike, ndonjëherë gjer në ekzaltim (kjo tek ndonjë valltar me individualitet të veçantë), është më e madhe se vetë rritja e muzikës që i shoqëron, e megjithatë nuk ekziston aritmi. Ajo që mban ekuilibrin në mes të lëvizjeve të valles dhe muzikës është lodra. Pikërisht këtu qëndron ajo pasuri e madhe ritmesh, me lloj lloj variacionesh e kadencash, si dhe ajo euritmi lëvizjesh me gjithfarë nuancash të bukura. Ndërmjet lëvizjeve dhe frazave muzikore në valle, me përjashtim të ndonjë rasti, nuk ka përputhje. Në këtë rast ajo që bie në sy dhe, për mendimin tonë më kryesorja, është se valltari i parë (vetëm ky kërcen, ndërsa i dyti e mban), duke mos iu nënshtruar asnjë rregulli, e përsërit të njëjtën lëvizje dy, tri, katër herë ose më shumë, simbas dëshirës së vet, ndoshta dhe me një spontanitet, që as vetë nuk e kupton. Ky është një fenomen i njohur edhe në gjinitë e tjera të folklorit. Ai u jep valleve një fizionomi të veçantë strukturale dhe një farë liriye n'ekzekutim (në përsëritjen e lëvizjeve). Madje duhet të shtojmë se vallet e tipit të «randë» dhe të «lehtë» kanë dhe motërzimet e tyre, ku një rol të madh luan individualiteti i valltarëve mjeshtër. Kjo asht arsyeja që këto valle paraqiten në variante me veçori dhe karakteristika të ndryshme.

Po paraqesim disa nga vallet e burrave:

VALLJA E RANDË ose siç i thonë vendasit «vallja e randë e Zall-Dardhës». E quajnë kështu sepse vallja ekzekutohet rëndë, me lëvizje të ngadalta e të shtruara. Këto tipare ka edhe muzika që e shoqëron. Për këtë valle ka shumë melodi, dhe sipas kajdes, sipas rënies së lodrës shkojnë dhe këmbët, ku një rol të madh luan individualiteti i valltarit. Pra, kemi disa variante të saj. Disa syresh nisin e mbarojnë me lëvizje të ngadalta, kurse disa të tjera përfundojnë me kthesë të shpejtë. Kur duan të shkojnë këtë valle në ndonjë rast thonë: «po honi or burra kush na merr ni t'ranë?», ose «na merrni at dishen (dyshe) e ranë!» Po paraqesim disa lëvizje të një nga varianteve të valles së rëndë, të filmuar në festivalin e këngës dhe valles të vitit 1961 zhvilluar në Tiranë. Kjo valle (edhe variantet e tjera) luhet prej dy valltarëve, i pari kërcen ndërsa i dyti e mban duke e shoqëruar edhe me lëvizje të trupit të pacaktuara dhe xheste, nuanca këto më fort të rastit. Vallja fillon me lëvizje të ngadalta: ngritje e këmbës së thyer përpara, mbrapa duke e kryqëzuar, ndërsa trupi për-kulet pakëz mbrapa; pastaj vijnë uljet me të dyja këmbët për t'u ngritur vrrik në majë të gishtave, ose gjysëm kthesat e trupit majtas, djathtas

në gjysëm ulje. Me një rrotullim të ngadaltë nga e majta valltari i parë i del përpara valltarit tjetër për ta lënë atë në krye të valles. Këtu fillon «kthesa» e valles. Kthesa nis me hapin karakteristik; hapat janë të gjëra e në majë të gishtave me lëvizje e nuanca të tepërta të trupit. Kjo është si një përgatitje për uljet e mëdha kryq me të dyja këmbët që e pasojnë. Pastaj valltari ulet mbi këmbën e majtë, të djathtën e shtrin përpara, ndërsa trupi i shtrirë mbrapa mbështetet në tokë me dorën e djathtë. Nga ky qëndrim valltari ngrihet për të bërë hedhje me rrotullime nga e djathta, ndërsa këmba e djathtë, mbasi kryqëzohet e thyer, shtrihet përpara posa valltari bie në tokë me këmbën e majtë. Këto lëvizje përsëriten me variacione të ndryshme. Një detyrë me rëndësi ka valltari i dytë që e mban, sepse lëvizjet dhe figurat vallzuese janë tepër të gjalla me një karakter akrobatik, me gjithë farë nuancash dhe lëvizjesh të zhdërvjellta të trupit. Vallja mbaron në një moment të pacaktuar, kur valltarët e ndjejnë vехten të lodhur. Vallja e «randë», mbetet si një ndër kërcimet më të bukur e më të preferuar, në të njëjtën kohë dhe më të vështirë. E kërcëjnë zakonisht më të vjetrit, pleqt, por edhe të rinjtë, sidomos kur vallja luhet edhe me kthesën.



Vallja e randë

VALLJA E LEHTË — Vallet e këtij tipi luhet në shumë variante. Gjatë kërkimeve rreth valleve, ne mundëm të transkriptojmë tri të tilla: një në katundin Kraj-Reç dhe dy në lokalitetin e Zall-Dardhës, prej të cilave një nga të vegjlit dhe dy të tjerat nga të rinjtë dhe të rriturit. Në përgjithësi motivet e këtyre valleve janë të pasura dhe shumë të larmishme, si në një valle të vetme ashtu dhe në të gjitha ato së bashku po t'i krahasojmë në mes tyre. Veçori kryesore e këtyre valleve asht se ato janë shumë kërcyese, të lehta, me kombinime hapash të shumëllojshëm e nga më të ndryshmit. Motivët muzikore që i shoqërojnë këto lloj vallesh përftojnë jone të bukura dhe nga më karakteristiket të repertorit të muzikës së valleve. Pothuajse të gjitha këto melodi nisin lehtë dhe dalëngadalë rriten në crescendo. Këto tipare i shohim edhe në lëvizjet e valleve. Valltarët e nisin kërcimin ngadalë lehtë-lehtë, por shumë shpejt i japin forcë trupit duke ekzekutuar lëvizje e figura të gjithëfarëshme, me hedhje nga njera këmbë në tjetrën, me rrotullime, ulje në të dyja këmbët, agritje

në majë të gishtave, hedhje lart n'ajër, ndërsa trupi duke qenë i lirë sajón gjithfarë nuancash. Zakonisht vallet e lehta janë shumë të gjalla, dhe kërkojnë mjeshtri n'ekzekutimin dhe interpretimin e tyre. Edhe në këto valle një rol luan individualiteti i valltarëve. Luhen zakonisht nga dy valltarë, nga të cilët vetëm i pari kërcen, ndërsa i dyti e mban. Kur vallja luhet me nga katër valltarë e lart (siç ishte rasti që e pamë nga të vegjlit e Zall-Dardhës) lëvizjet janë më të përcaktuara dhe unike për të gjithë. Muzikalisht vallja luhet në kohën 7/8.

Po përshkruajmë një lëvizje nga vallja e lehtë (Kraj-Reç)

Masa I

Tetshja e parë — e dytë — Hedhje në vend me këmbën e majtë pak të thyer ndërsa e djathta ngrihet pranë sajë e thyer, me kthimin e trupit djathtas (pika 3). I pari me dorën e djathtë lëviz shaminë lart në ajër.

Tetshja e tretë — e katërt — Hedhje nga këmba e majtë mbi të dyja këmbët të thyera anash nga e djathta (pika 3), në kthimin e trupit majtas (pika 1). Trupi përkulet pak përpara. I pari dorën e djathtë e ul në pozicion normal.


Tetshja e pestë — Hedhje në vend nga të dyja këmbët (këmbët ngrihen duke u mbledhur përbrenda) mbi të djathtën të thyer, ndërsa e majta e thyer del përpara në ajër. Trupi n'atë pozicion kthehet gjysmë djathtas (pika 2). I pari lëviz shaminë lart në ajër.

Tetshja e gjashtë — e shtatë — Hap i thyer me të majtën anash nga e djathta (pika 3). Trupi i përkulur pak përpara është i mbështetur mbi këmbën e majtë.

Masa II — Në këtë masë përsëritet lëvizja e mësipërme e masës I.

Shenim: Kjo lëvizje përsëritet në mënyrë të pacaktuar

Valle e Lehtë



Një tjetër lëvizje nga një variant i valles së lehtë (Zall-Dardhë).

Masa I

Tetshja e parë — e dytë — Hedhje në vend mbi këmbën e majtë pak të thyer, ndërsa e djathta e thyer kryqzohet përpara 90°. Valltarët janë të kapur me duart zinxhir: i pari me dorën e djathtë lëviz shaminë lart në ajër, kurse i fundit dorën e majtë e mban mbrapa poshtë belit.


Tetshja e tretë — e katërt — Hap pak i thyer me të djathtën anash nga e djathta (pika 3) me kthimin e trupit gjysëm djathtas (pi-

- ka 2). Trupi mbështet lehtas mbi këmbën e djathtë. Duart qëndrojnë në atë pozicion.
- Tetshja e pestë** — Hedhje nga këmba e djathtë mbi të majtën, pak në majë të gishtave, ndërsa e djathta e thyer, ngrihet mbrapa pak përmbi tokë 45° . I pari vendos dorën mbrapa poshtë belit.
- Tetshja e gjashtë e shtatë** — Hap me të djathtën përnjëherë me ulje të madhe mbi të dyja këmbët pak të hapura (e djathta përpara, e majta pak në majë të gishtave). Trupi përkulet pak përpara. Duart qëndrojnë në atë pozicion.

Masa II

- Tetshja e parë** — Ngritje në majë të gishtave në vend (me thembrat nga jashtë), me kthimin e trupit gjysëm majtas (pika 1). I pari dorën e djathtë e nxjerr anash.
- Tetshja e dytë** — pushim
- Tetshja e tretë e katërt** — Ulje e madhe në vend me të dyja këmbët e hapura pak në majë të gishtave (e majta del pak përpara së djathtës). Trupi përkulet pak përpara. I pari dorën e djathtë e ul në pozicionin normal.
- Tetshja e pestë** — Ngritje në majë të gishtave në vend (me thembrat nga jashtë). Trupi ngrihet në pozicion normal. I pari dorën e djathtë e nxjerr anash.
- Tetshja e gjashtë e shtatë** — Pushim.

Valle e lehtë



VALLJA E XHAFERR KABES — Origjina e kësaj vallje është e vonë. Këtë e krijoi, 10-15 vjet më parë, Xhaferr Kaba prej fshatit Pilof (i qendrës së rrethit Dibër) nga i cili mori emrin edhe kërcimi. Bashkë me vallen ai nxorri (kompozoi) edhe melodinë e saj. Autori për këtë u mbështet në stilin e strukturës së valleve dhe të muzikës popullore vendase. Këto figura të valles ia pështeti gjendjes së tij fizike (këmbës së djathtë nuk i lëviz artikulationi i gjunit). Vallja e Xhaferr Kabës njihet dhe luhet pothuaj në të gjithë rrethin e Dibrës. Asht valle «dyshe». I pari kërcen me ndihmën e një shkopi-bastun, ndërsa i dyti e mban. Hapat e valles çvendosen në drejtim të vargut të valles, anash nga e djathta.

Vallja shpreh këtë përmbajtje: një njeri çalaman don të kërcëjë edhe pse nuk e lejon gjendja fizike; ai ka dëshirë dhe mundohet të kërcëjë. Krijohet pra një atmosferë e gëzueshme. Vallja shquhet për hapat karakteristike si: ngritje e këmbës së pathyer në drejtime të ndryshme, ose dhe në ulje të mëdha, hecje me këmbën të shtrime, hapa kryq mbrapa, etj. Të gjitha lëvizjet valltari i parë i bën me ndihmën e shkopit. Ritmika e valles në përgjithësi është e shtruar. Ndërmjet frazave muzikore dhe lëvizjeve ekziston përputhje e plotë. Muzika e valles ekzekutohet në kohën 2/4.

Po përshkruajmë një moment nga vallja e «Xhafer Kabës» (Zall-Dardhë).

Masa I

Katërshja e parë — Këmbe e majtë qëndron në vend, pak e thyer, ndërsa e djathta kryqëzohet përpara pak përmbi tokë me kthimin e trupit gjysëm majtas (pika 8). Valltarët janë të zënë për krahu. Trupi mbështetet lehtas mbi shkopin, të cilin valltari i parë e mban në dorën e djathtë.

Katërshja e dytë — Këmbe e majtë hidhet pakëz në vend, ndërsa e djathta në atë pozicion drejtohet me majën gjysëm djathtas (pika 2) përnjëherë me kthimin e trupit në të njëjtin drejtim. Duart qëndrojnë në atë pozicion.

Masa II — Në këtë masë përsëritet lëvizja e masës I-rë.
Masat III-IV — Në këto dy masa përsëritet lëvizja e masave I-II.


Masa V

Katërshja e parë — Hap me të djathtën në majë të gishtave anash nga e djathta (pika 3), ndërsa e majta ngrihet mbrapa pak përmbi tokë me kthimin e trupit gjysëm djathtas (pika 2).

Katërshja e dytë — Hap kryq, pak i thyem me të majtën mbrapa, ndërsa e djathta qëndron e shtrime. Trupi mbështetet mbi kambën e majtë.

Masat VI-VII-VIII — Në këto tri masa përsëritet lëvizja e masës V e përsëritur tri herë.

Shenim: kjo lëvizje kombinohet edhe me të tjera lëvizje dhe përsëritet pa caktim.

Vallja e Xh. Kabës

Vallja e Xhafer Kabës

VALLJA E HAXHI KACES — Kjo valle luhet në të gjithë krahinën e Zall-Dardhës. Vendasit thonë se melodinë, bile (por jo me siguri) edhe vallen e krijoi Xhaferr Kaci, prej fshatit Nezhaj, nga i cili mori emërin kërcimi. Është valle dyshe, variant i tipit të valleve të «lehta». E kërcën vetëm i pari, i cili me dorën e djathtë lëviz një shami në ajër, kurse i dyti e mban. Vallja, në përgjithësi, karakterizohet për lëvizjet e lehta plastike, nuancat e trupit dhe lëvizjen e dorës së djathtë në drejtime të ndryshme, për hapat gjysëm të thyera, ngritjen e këmbëve në ajër, për hapat dubël me hedhje e me rrotullime, me ulje të mëdha e tjera. Gjatë kërcimit pjesa e sipërme e trupit përkulet pak përpara.

Nga pikëpamja ritmike melodia e valles fillon e shtruar dhe dalëngadalë, veçanërisht nga fundi, rritet në mënyrë relative. Ky ndryshim i melodisë vjen bashkë me rritjen plastike të lëvizjeve të valles, ekzekutimi

i të cilave mvaret edhe nga individualiteti i valltarit. Kjo i jep valles një farë strukture të veçantë: në fillim të ngadaltë, ndërsa nga mezi e lart përfundon me lëvizje kërcyese e të gjalla. Muzika e valles ekzekutohet në kohën 2/4.

Po përshkruajmë një moment nga kthesa e valles së Haxhi Kacës (Lashkizë)

Masa I

Gjashtëmbëdhjetshe — Hedhje me këmbën e majtë pak të thyer anash nga e djathta (pika 3), ndërsa e djathta ngrihet përpara pak përmbi tokë, me kthimin e trupit gjysëm djathtas. Trupi është i përkulun pak përpara. Valltarët janë të kapur me duar të thyera anash zinxhir: i pari dorën e djathtë dhe i dyti dorën e majtë e vendosin mbrapa, poshtë belit.

Tetshe + gjashtëmbëdhjetshe — Hap pak i thyer me të djathtën anash nga e djathta (pika 3). Trupi mbështet lehtas mbi këmbën e djathtë. Duart qëndrojnë në atë pozicion.

Gjashtëmbëdhjetshe — Hedhje e vogël me këmbën e djathtë pak të thyer ndërsa e majta ngrihet përpara pak përmbi tokë. Trupi dhe duart qëndrojnë në atë pozicion.

Tetshe + gjashtëmbëdhjetshe — Hap pak i thyer me të majtën. Trupi mbështet lehtas mbi këmbën e majtë. Duart qëndrojnë në atë pozicion.

Masa II — Në këtë masë përsëritet lëvizja e masipërme e masës I-rë, vetëm me ndryshimin se hapi sinkopë në kohën e dytë, bëhet me rrotullimin e trupit nga e djathta 270°. Trupi qëndron në atë pozicion. I pari, të dyja duart i nxjerr pak anash, ndërsa i dyti, me dorën e djathtë e mban.

Masa III

Katërshja e parë — Hedhje me këmbën e majtë, pak të thyer, në vend, ndërsa e djathta mbasi kryqëzohet e thyer në ajër shtrihet përpara pak përmbi tokë. Trupi është i orientuar përpara. Valltarët kapen zinxhir: i pari lëviz shaminë lart në ajër.

Katërshja e dytë — Hap i thyer me të djathtën anash nga e djathta (pika 3). Trupi mbështetet mbi këmbën e djathtë. Trupi dhe duart qëndrojnë në atë pozicion.


Masa IV — Në këtë masë përsëritet lëvizja e masës së mesipërme, vetëm me ndryshimin se ekzekutohet me hap të kundërt.

Masa V

Katërshja e parë — Hedhje me këmbën e majtë, pak të thyer, në vend, ndërsa e djathta mbasi kryqëzohet e thyer në ajër shtrihet përpara pak përmbi tokë. Trupi dhe duart qëndrojnë në atë pozicion.

Katërshja e dytë — Ulje e madhe (grand plyie) në vend me gjithë shuallin e këmbëve. Trupi qëndron në atë pozicion. I pari dorën e djathtë e ul në pozicion normal.

Vallja e Haxhi Kaçës



Vallja e Haxhi Kaçës

Përveç valleve të ilustrueme edhe me shembuj, në fondin e kërcimeve popullore të kësaj krahine zënë vend edhe valle të tjera si p.sh.: vallja e shpejtë e Zall-Dardhës, Shumbatit, Dom Kallës, Çapkonit, Mustafajt, Hysen Bellovës, etj. Secila nga këto valle paraqet interes të veçantë si për elementët koreografikë e trajtën, ashtu edhe mënyrën e ekzekutimit. Megjithatë, duhet thënë se, në strukturën dhe mbrendinë e këtyre valleve, ne shohim edhe tipare të përbashkëta, si në motivet, karakterin, dinamizmin, forcën e madhe shprehëse të tyre, kategorizimin etj., veçori dhe cilësi këto që formojnë në përgjithësi stilin e këtyre kërcimeve.

Në përgjithësi të gjitha vallet, për të cilat u bë fjalë më lart, janë shumë të vjetra. Në strukturën e tyre, e më tepër në mënyrën e ekzekutimit, shohim veçori e karakteristika, natyrisht edhe me ndryshimet përkatëse, të cilat janë rezultat i një mënyre të përbashkët jetese, i atyre marrëdhënieve sociale, ambjentit gjeografik, klimës, etj. Pra, mund të themi se, i gjithë repertori i vallzimit të kësaj krahine është frut i shumë brezave.

Krijimtaria popullore, në përgjithësi, ka një karakter anonim, por kjo nuk do të thotë se prezenca dhe roli i individit nuk duhet marrë para-

sysh. Si çdo krijimtari, ashtu dhe vallja, është rezultat i shumë njerëzve, të cilët kontribuojnë simbas shkallës së aftësive dhe prirjeve të tyre; brezi i mëvonshëm e përvehtëson këtë si një eksperiencë të trashëgueme. Por qëllon që, në kushte të veçanta, individi t'i japë kësaj apo asaj valleje përtëritje, ta gjallërojë me elementë të rinj. Këtë na e dëshmon fakti që, vallet, shpesh herë kanë marrë emra njerëzish. Ngandonjëherë roli i individit është aq i madh, sa ai, duke u ngritur mbi të tjerët, përgjithëson në mënyrë intuitive gjithshka të trashëguar dhe mbi këtë krijon diçka të vetën. Për këtë mund të përmëndim vallen e «Xhaferr Kabës» si shembëllin më të mirë, që tregon rolin e individit në krijimtarinë folkloristike të vallëzimit popullor edhe sot e kësaj dite.

Problemi i pasurimit dhe i përtëritjes së valleve popullore, është një fenomen që duket dhe në vende të tjera. Muzikologia dhe koreologjia bullgare R. Katzarova, në një artikull të sajën «La tradition et l'esprit novateur dans la dans populaire (Journal of the International Folk Music Council. Vol. XV-V/1963, f. 63) këtë fenomen e konstaton të çfaqur në tre aspekte: 1. kur një «rondo» e përcaktuar fillon të kërcehet me një muzikë të re, gjë e cila sjell ndryshim në ritëm dhe tendencë për të theksuar disa lëvizje dhe disa xheste. 2) Kur melodia nuk ndryshon, po kur valltarët sjellin ndryshime në hapa, në lëvizje dhe xheste. 3) Në ndryshimin e përnjëherëshëm të melodisë dhe të kompozicionit koreografik. Pikërisht përcaktimi i fundit ka gjasë me shembullin e valles së Xhaferr Kabës, që e përmëndëm më lart. Bile, këtu mund të shtojmë pa frikë, se, nuk kemi «ndryshim të menjëherëshëm», por krijim të vërtetë si të melodisë ashtu dhe të kompozicionit koreografik. Kjo tregon, se, tek ne, folkloristika e valleve rron e gjallë, se ajo vazhdon të pasurohet me motive dhe elementë të rinj. Shembëllat që dhamë na mjaftojnë për të hedhur poshtë mendimin borgjez që thotë se, folklori nuk është gjë tjetër, vetëm se një jehonë, krijimi i së kaluarës. Përkundrazi, në kushtet konkrete të jetës sonë, ku marrëdhëniet socialiste zotërojnë në të gjitha fushat e jetës, ku ideali i së arthmes është i përbashkët, pjesëmarrja dhe aftësitë e njerëzve për të krijuar, janë jo vetëm të mundëshme, por edhe më të mëdha se kurrë.

Kërcimet, për të cilat bëmë fjalë shkurtimisht në këtë studim, formojnë një unitet koreografik relativisht më vehte. Tue marrë parasysh se disa tipare të përbashkëta, ndonse të pakta, si në trajtë ashtu dhe në mënyrën e ekzekutimit, i gjejmë edhe më në veri në rrethin e Kukësit, ose dhe në krahinat fqinje më në jug, e veçanërisht në lokalitetet e tjerë të vetë rrethit të Dibrës, mund të vijmë në përfundim, se i gjithë krijimi artistik i valleve të Zall-Dardhës është pjesë vijuese dhe përbërëse e atij uniteti kombëtar koreografik, i krijuar dhe i trashëguar brez pas brezi.

KARAKTERISTIKAT MUZIKORE TË VALLEVE TË ZALL-DARDHËS. — Populli i krahinës së Zall-Dardhës, krahas valleve, ka krijuar edhe një sërë melodishë për shoqërimin e tyre. Këto melodi, sikundër vallet, janë shumë të vjetra dhe të trashëguara, brez pas brezi. Shumica e tyre janë anonime, por ka edhe nga ato që janë krijuar në kohë të vona dhe nga njerëz të njohur. Përsa i përket këtyre të fundit vlen të përmëndet, se autorët e melodive krahas tyre mund të kenë nxjerrë edhe kërcimin. Rapsodët popullorë, për këto melodi vallesh, inspirimin e kanë gjetur në jetën, traditat vendase dhe në natyrën piktoreske. Këto melodi janë të shumta dhe njihen sipas valleve përkatëse. Ndërtimi i tyre është i ndryshëm; aty dallojmë karakteristika të veçanta si në strukturë ashtu dhe në përmbajtje. Këto ndryshime vërehen tek muzika e valleve

të grave, dhe veçanërisht tek ajo e valleve të burrave, megjithëqë këto të fundit karakterizohen në përgjithësi nga një stil i përbashkët që i dallon për autoktonitetin e tyre. Meloditë në veçanti janë të ndërtuara nga një (rrallë), dy, tri ose dhe katër fraza muzikore. Po t'i krahasojmë këto melodi, për sa i përket rrjeshtimit dhe përsëritjes gjatë ekzekutimit të frazave muzikore, do të shohim se në disa raste ka, dhe në disa të tjera nuk ka një rregull të caktuar. Frazat në vetvehte kanë ndërtim të rregullt. Ato zakonisht janë dy (rrallë), katër ose tetë masash. Masat paraqiten në kohë të ndryshme. Më të rëndomtë janë në kohën 2/4. Edhe epitriti (me skemën 1-2, 1-2, 1-2-3) është mjaft i përdorur. Në rastet kur vallet shoqërohen me surlë e lodër, paraqiten me një ritëm të tillë që është vështirë të dallosh dhe të përcaktosh me saktësi vlerën ritmike të skemave të tyre. Kjo vjen për shkak se lodërtari improvizon variacione ritmesh me gjithfarë kadencash që të duken, sikur nuk përputhen me surlen e cila ekzekuton vijën melodike, megjithëqë në bazën e tyre ekzistojnë kohë të barabarta. Karakteristike asht se disa nga vallet, si p.sh. vallja e rrafshët e grave e ndonjë tjetër, luhen me dy ose tri melodira krejtësisht të ndryshme nga njera tjetra.

Instrumentet që përdoren për shoqërimin e valleve janë: surlja, lodra, çiftelia dhe daireja. Ekzekutues të këtyre instrumenteve (fjala është për surlën dhe lodrën) janë vendasit, xhibët, të cilët edhe i punojnë vetë ata, ndërsa çiftelia përdoret dhe punohet edhe nga të tjerë.

* * *

Ekspedita jonë që u bë në Zall-Dardhë për vallet, ndonse e shkurtër, i përfundoi në mënyrë të kënaqëshme parashikimet e saj.

Ne nuk i vumë për detyrë vehtes që të bënim një eksplorim në thellësi të problemit në fjalë. Detyra jonë e caktuar, që të mirreshin me njohjen e përgjithëshme, qoftë edhe në veçanti të disa specimeneve të kësaj gjinie u realizua, bile në ndonjë drejtim u tejkalua. Ne mundëm të përshkruajmë, në kontakt të drejtpërdrejtë me valltarët vendës, një numër vallesh. Në këtë mënyrë ne kemi nëpër duar një material faktik (pos të dhënave informative rreth valleve), i cili do të na shërbejë jo vetëm si një dokumentacion, por edhe si një material nga ku mund të nxjerrim konkluzione mbi probleme të ndryshme të folkloristikës së valleve, qoftë edhe në planin e krahasimeve.

Një kontribut për realizimin me sukses të ekspeditës dhanë grupet e valleve të fëmijëve, të të rinjve si dhe individë të ndryshëm si: H. Ndreu, Se.Ç. Çerpja, T. Toluli, Xh. Laçi, Q. Selimi, I. Rasha etj. etj. Ndihmë të vlefshme dhanë edhe organet e pushtetit (seksioni i arësimit) dhe veçanërisht përgjegjësi i shtëpisë së kulturës të lok. Zall-Dardhë A. Rama.

